

KA. nr.1037/2013

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Biljana Rexhiq kryetare e kolegjit, Dalip Bega dhe Mejreme Zekaj anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtoren profesionale Sebahate Hoti, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga mbrojtësi i të pandehuri Boban Predrag Filipoviç, avokati Zharko Gajiç kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore-Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr.regj.45286/2013, të dt. 12.09.2013, në bazë të nenit 31 al.3-39 dhe 222 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 08.10.2013, merr

A K T V E N D I M

Ankesa e paraqitur është e **BAZUAR**.

ABROGOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore-Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr. regj. 45286/2013, të dt. 12.09.2013, dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në plotësim të procedurës.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore-Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, me aktvendimin Nr. regj. 45286/2013, të dt. 12.09.2013, të pandehurin Boban Predrag Filipoviç nga fshati Kuzmin, Komuna e Fushë Kosovës, e ka shpallë përgjegjës:

Sepse si Zyrtar i Lart Publik, Nënkyetar i Komunës së Fushë Kosovës, nuk i ka ven në dispozicion të dhënat e kërkuara me shkrim nga Agjencia në afatin kohor sipas Ligjit nr.04/1-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lart publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, me ç, veprim i pandehuri ka bërë kundërvajtje nga neni 15 par.3 të Ligjit nr.04/1-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, për të cilën kundërvajtje të pandehurit i shqiptoj gjoja në shumë prej 1000 Euro. Me të njëjtin aktvendim i pandehuri është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 15 Euro.

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të pandehuri Boban Filipoviç, av. Zharko Gajiç, për shkak të shkeljes esenciale së dispozitave procedurale, aplikimit të gabuar të ligjit, vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike, dhe vendimit mbi dënimin, në arsyetimin e ankesës shton: dispozitivi i aktvendimit është i pa qartë dhe i papërcaktuar, nga e njëjta nuk shihet se kur i pandehuri e ka krye kundërvajtjen, cilën dit, vend dhe mënyrën, elemente këto që e formojnë figurën e veprës kundërvajtëse, pastaj dispozitivi i aktvendimit është në kundërshtim me arsyetimin e aktvendimit, në arsyetim thuhet se i pandehuri ka plotësuar formularin nr.A-13, që do të thotë ka plotësua formularin e duhur, në arsyetimin e aktvendimit ceket se gjoja Agjencia me dt. 22.08.2013, të pandehurit ja ka dërguar njoftimin që në afat prej 15 ditësh të përmirësoj gabimet, mirëpo nuk ceket data-koha kur i pandehuri e ka pranua njoftimin, për ndryshe i pandehuri nuk e ka pranuar njoftimin e Agjencisë, pastaj gjykata me rastin e dërgimit të ftesës të pandehurit për marrje në pyetje nuk ja ka dërgua kopjen e kërkesës për inicim të procedurës. Me rastin e marrjes në pyetje i pandehuri nuk është udhëzua për të drejtën e angazhimit të mbrojtësit ligjor-avokatit. Propozon që ankesa të aprovohet si e bazuar ndërsa aktvendimi i kundërshtuar të ndryshohet dhe i pandehuri të lirohet nga përgjegjësia dhe dënimi i shqiptuar ose të priset dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO		REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORUPSIONIT		AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY		ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.		Nr. Prot.	
Dep.	DPK/DMP	Br.Prot.	03-3961/A3
Dep.		Prot No.	
Nr. i faq.		Data	
Broj stranica	02	Datum	19.11.2013
Nr. pages		Date	

